



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 293, Datë 12.10.2023**

**MBI**

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR MIRATIMIN E  
PLANIT DHJETËVJEÇAR TË INVESTIMEVE NGA SHOQËRIA ALBGAZ SH.A.**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; neneve 16, pika 12; 46 dhe 56, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar; neneve 8, 9, 10 të Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 18, datë 10.01.2018; si dhe neneve 15 dhe 19 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 12.10.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2152/4 prot., datë 10.10.2023 të përgatitur nga Grupi i Punës “Mbi fillimin e procedurës për shqyrtimin e kërkesës së planit të dhjetëvjeçar të investimeve për periudhën 2023 - 2032 të Shoqërisë Albgaz sh.a.”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “Albgaz” sh.a., në cilësinë e Operatorit të Kombinuar të gazit natyror, nëpërmjet shkresës me nr. 103 prot., datë 12.09.2023, protokolluar me tonën me nr. 2152 prot., datë 12.09.2023, paraqiti kërkesën për miratimin e Planit të Investimeve dhjetëvjeçar, të zhvillimit të rrjetit të transmetimit për Gazin Natyror në Republikën e Shqipërisë, që përmban investimet afatshkurtra e afatmesme të kompanisë.
- Aplikimi për miratimin e Planit të Investimeve dhjetëvjeçar nga ERE është bërë në përputhje me dispozitat e parashikuara në nenin 46 dhe 56 të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 8, pikës 1 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e Transmetimit dhe Shpërndarjes së gazit natyror”, miratuar me vendimin të bordit të ERE-s nr. 18, datë 10.01.2018.
- Shoqëria “Albgaz” sh.a. deklaroi se parimet e ndjekura në hartimin e planeve të investimeve janë në harmoni me strategjinë kombëtare të zhvillimit të sektorit të gazit natyror, të miratuara me VKM-në nr. 87/2018 “Për miratimin e Planit Kombëtar për Sektorin e Gazit (Master Planit të Sektorit të Gazit për Shqipërinë, e ndryshuar me VKM-në nr. 563, datë 04.10.2023, të

parashikuara në nenin 6, gërmat “a” dhe “b” të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e Transmetimit dhe Shpërndarjes së gazit natyror”.

- Në zbatim të nenit 8, pikës 6, gërma “d” të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e Transmetimit dhe Shpërndarjes së gazit natyror”, shoqëria duhet të paraqesi një analizë të plotë të përfitimit të kostos që vërteton efektivitetin e çdo projekti të planifikuar dhe justifikon kostot që lidhen me to.
- Në zbatim të nenit 6, gërma “f” të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e Transmetimit dhe Shpërndarjes së gazit natyror”, shoqëria “Albgaz” sh.a., ka detyrimin e publikimit të planit të investimit në faqen e saj zyrtare. Në kuadër të aplikimit në ERE shoqëria “Albgaz” sh.a. ka bërë me dije se në përputhje me nenin 10, pika 1 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e Transmetimit dhe Shpërndarjes së gazit natyror”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 18, datë 10.01.2018, është bërë konsultimi për marrjen e opinionëve nga palët e interesit, njoftime të cilat gjenden të publikuara në faqen e MIE, KKT dhe QPZ.
- Shoqëria “Albgaz” sh.a., aplikimin për miratimin e planit të investimeve, e ka shoqëruar me dokumentacionin dhe disa raporte, studime fizibiliteti, marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet disa operatorëve dhe Ministrisë së Infrastrukturës (MIE) duke përfshirë ndër të tjera si vijon:
  - Shkresën nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), nr. 6429/1, datë 21.08.2023 nëpërmjet së cilës shprehet gadishmëria dhe mbështetja e MIE-s në realizimin e këtij projekti gjatë vitit 2023;
  - Shkresën nga Korporata Elektroenergjitike Shqiptare (KESH) sh.a. nr. 3933/4 prot, datë 11.09.2023, nëpërmjet së cilës ka kërkuar nga shoqëria “Albgaz” sh.a. që për kapacitet e instaluar të TEC Vlora, për një regjim maksimal në 80%, sasia vjetore e nevojshme e gazit do të jetë në rreth 130 mcm në vit.
- Shoqëria “Albgaz” sh.a. duhet të depozitojë në ERE opinionin nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë në lidhje me planin e investimeve në zbatim të nenit 10, pika 3 të “Rregullores për procedurat e paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e Transmetimit dhe Shpërndarjes së gazit natyror”; një tabelë përmbledhëse ku evidentohen investimet e planit dhjetëvjeçar me zërat dhe vlerat përkatëse bashkë me periudhën kur do të kryhen investimet duke cilësuar dhe burimin e financimit, si dhe çdo informacion apo dokumentacion tjetër të nevojshëm për të cilin mund të lindi nevoja gjatë procesit të shqyrtimit të planit të investimeve bazuar në legjislacionin në fuqi.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për miratimin e “Planit të investimeve dhjetëvjeçar nga Shoqëria “Albgaz” sh.a.

2. Drejtoria e Gazit Natyror, të njoftojë aplikuesin, Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**

